

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Prot Nr. 288/2

*Krume me
11/05/2018*

Për: **Trezhnjeva shpk,**

Adresa: Lagjia Partizani, Rruga Jaho Salihi, Pallati Nr.90/3, Shk. Nr.1, Ap. Nr.5, Tropoje

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim, me mjete elektronike**

Numri i referencës së procedurës: **REF-41179-01-19-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, për vitin 2018” – Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj.**

Fondi i Marrëveshjes Kuader për 12 muaj – 2.916.569 (dy milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nente) LEKE pa TVSH.

Fondi limit për një vëndroje/Ditore - 7990,6 (shtatë mijë e nentëqind e nentëdhjetë/6) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike **Nr 4 , date 29.01.2018, faqe 67.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Shtiqni shpk, me NIPT K37508217T,

Vlera 1604,51 (njemijegjashteqindekater,51) lekë pa TVSH, vlere ditore;

2.Eurogjici Security shpk, me NIPT K31929010K,

Vlera 7988,20 (shtatemijenenteqindetetehjetetete,20) lekë pa TVSH, vlere ditore;

3.Trezhnjeva shpk, me NIPT K19303605O,

Vlera 7988,96 (shtatemijenenteqindetetehjetetete,96) lekë pa TVSH, vlere ditore;

4.Nazeri 2000 shpk, me NIPT K31422029Q,

Vlera 7990,45 (shtatemijenenteqindenentedhjetete,45) lekë pa TVSH, vlere ditore;

5.Sabeta shpk, me NIPT K37508289P,

Vlera 585646,15 (peseqindepesedhjetepesemijegjashteqindedyzetegjashte,15) lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **SHTIQNI shpk,** përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) *Autoriteti kontraktor në DST, shtojca nr 1 Formulari i Ofertes Ekonomike ka kerkuar nga operatorët ekonomik që të deklarojnë ofertën e tyre për Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, **per 1 vend roje me 3 turne në ditë**, e cila në bazë të analizës së kostos së paraqitur nga operatori*

Dokumentat Standarde të Tenderit

ekonomik Shtiqni shpk eshte 7990,45 leke pa TVSH. Operatori ekonomik Shtiqni shpk ne formularin e ofertes ka deklaruar çmimin e ofertes 1604,51 leke pa TVSH. Komisioni i Vlersimit te Ofertave konstaton se operatori ekonomik Shtiqni shpk, formularin e ofertes ekonomike e ka plotesuar ne kundershtim me kerkesat e Autoritetit Kontraktor (Shtojca 1 Formulari i Ofertes Ekonomike, sqarime pika 1). **Rrjedhimisht kjo kerkese e Autoritetit Kontraktor eshte e papermbushur.**

2. EUROGJICI SECURITY shpk, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Komisioni i Vlersimit te Ofertave konstaton se paga baze per nje roje ne dite dhe rrjedhimisht edhe paga baze per nje vend roje me tre turne ne dite te paraqitura nga operatori ekonomik Eurogjici Security shpk, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar. Komisioni i Vlersimit te Ofertave pasi kontrolloi analizen e kosos, konstaton se perlllogaritja e pages baze per nje roje ne dite dhe rrjedhimisht edhe paga baze per nje vend roje me tre turne ne dite nuk eshte e rregullt. Operatori ekonomik "Eurogjici Security" ne analizen e kosos ka perlllogaritur pagen baze per 1 roje ne dite = 36000 leke ne muaj/30.42 dite mesatarisht ne muaj = 1183,43 leke pa TVSH. Perlllogaritja nuk eshte e rregullt pasi viti del me 365,04 dite (30.42 dite mesatare ne muaj shumezuar me 12 muaj) dhe jo me 365 dite qe ka viti. Ne kete rast paga baze mujore eshte nen kufirin minimal ligjor te lejuar me VKM-ne nr. 399, datë 03.05.2017 si dhe ligjin për shërbimin privat të sigurisë fizike qe e kane percaktuar 36000 leke/muaj. Pasi paga baze ditore per nje roje e llogaritur nga operatori ekonomik "Eurogjici Security" qe eshte 1183,43 leke shumezuar me 365 dite qe ka viti dhe pjestuar me 12 muaj = 35995,99 leke qe eshte nen kufirin minimal ligjor te lejuar. Komisioni i Vlersimit te Ofertave bazuar ne VKM-ne nr. 399, datë 03.05.2017 "Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi", në ligjin nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", si dhe ne dokumentat standarte te tenderit shtojca nr 10 Formulari i ofertes ekonomike dhe shtojca nr 10 Sherbimet dhe grafiku i ekzekutimit, konstaton se perlllogaritja e pages baze ditore per nje roje ne dite brenda kufirit minimal ligjor te lejuar eshte: Paga baze mujore 36000 leke shumezuar me 12 muaj dhe pjestuar me 365 dite = 1183.56 leke dhe jo 1183,43 leke. Paga baze per nje vendroje me tre turne ne dite brenda kufirit minimal ligjor te lejuar eshte: Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne 4.98 shumezuar me 1183.56 leke = 5894.12 leke pa TVSH. Kurse paga baze per nje vendroje me tre turne ne dite e paraqitur ne analizen e kosos nga operatori ekonomik Eurogjici Security shpk eshte 5893.48 leke pa TVSH, pra eshte me e ulet. **Rrjedhimisht kjo kerkese e Autoritetit Kontraktor eshte e papermbushur.**

3. SABETA shpk, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Autoriteti kontraktor ne DST, shtojca nr 1 Formulari i Ofertes Ekonomike ka kerkuar nga operoret ekonomik qe te deklarojne oferten e tyre per Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorise se Sherbimit Spitalor Has, **per 1 vend roje me 3 turne ne dite**, e cila ne baze te analizes se kosos se paraqitur nga operatori ekonomik Sabeta shpk eshte 7990,49 leke pa TVSH. Operatori ekonomik Sabeta shpk ne formularin e çmimit te ofertes ka deklaruar çmimin e ofertes 585646,15 leke pa TVSH. Komisioni i Vlersimit te Ofertave konstaton se operatori ekonomik Sabeta shpk, formularin e ofertes ekonomike e ka plotesuar ne kundershtim me kerkesat e Autoritetit Kontraktor (Shtojca 1 Formulari i Ofertes Ekonomike, sqarime pika 1). **Rrjedhimisht kjo kerkese e Autoritetit Kontraktor eshte e papermbushur.**

Dokumentat Standarde të Tenderit

- b) *Kriteri i përgjithshëm i kualifikimit ku operatori ekonomik të ketë paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi, nuk është përmbushur pasi bazuar në vertetimin nr 9 prot date 26.01.2018 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukes, rezulton se operatori ekonomik Sabeta shpk ka detyrime tatimore. Në vetvete marrëveshja me Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukes nr 5441 prot, date 26.01.2018 është njohje dhe pranimi i detyrimit, nga ana e operatorit ekonomik Sabeta shpk, që për shkaqe të ndryshme, nuk ka mundur t'i përmbushë ato në kohë. **Rrjedhimisht kjo kerkese e Autoritetit Kontraktor është e papërmbushur.***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Trezhnjeva shpk, me NIPT K19303605O,

Vlera 7988,96 (shtatemijenenteqindetetdhjetetete,96) lekë pa TVSH, vlerë ditore; Vlera për periudhën 12 mujore është 7988,96 (shtatemijenenteqindetetdhjetetete,96) shumezuar me 365 dite baraz me 2915970,4 (dymilionenenteqindepesembedhjetemijenenteqindeshetatedhjetete,4) leke pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **[Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has me adrese Lagjia nr 2, qyteti Krume, Bashkia Has]**, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09/02/2018**

Ankesa: **ka pasur**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë **04/05/2018** sipas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr 280/2018, datë 04/05/2018.

Titullari i autoritetit kontraktor

Shkëlzen Ibra

